

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE

SHPALLJE PER VENDE TE LIRA PUNE

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise” (i ndryshuar), mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, date 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a. Vendimin Nr.11. datë 06.06.2024 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a”, Vendimit nr.9 date 18.12.2025, “Keshillit Mbikqyres”, Për miratimin e organigramës dhe nivelit te pagave për punonjësit e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a, shpallen procedurat e konkurimit per vend te lire pune:

2(dy Punetor Sherbimi KUZ Shkoder

Detyrat dhe pergjegjesite kryesore

- ✓ Punetori detyrohet të zbatojë disiplinen në punë, sipas Kodit të Punës, kontratës individuale dhe kësaj rregulloreje apo çdo akti tjetër në zbatim.
 - ✓ Punon në pastrimin dhe zhbllokimin e pusetave e të linjave të ujrave të zeza.
 - ✓ Merr pjesë në riparimet e linjave të tubacioneve dhe të pusetave të dëmtuara.
 - ✓ Bën zëvendësimin me tuba të reja dhe ngritjen e pusetave të dëmtuara.
 - ✓ Ngarkon e shkarkon materialet e ndryshme.
 - ✓ Zbaton rregullat e sigurimit në punë dhe në përputhje me ato që instruktohet.
 - ✓ Njofton specialistin për ndërtimet pa leje mbi tubacionet.
 - ✓ Shfrytëzon në maksimum kohën e punës dhe realizon çdo detyrë në kohë të ngarkuar nga Përgjegjësi.
 - ✓ Nuk i lëndon drejta e takimit të tubacioneve të kanalizimeve për privatët apo institucionet e tjera shtetërore pa miratim nga drejtuesit.
 - ✓ Ruan marrëdhënie të mira me klientët dhe nuk krijon konflikte me ta.
 - ✓ Duhet të ketë cilësi në punë.
1. Është përgjegjës për zbatimin e urdhrave. Në rast se shkel urdhrat , ndaj tij merren masa disiplinore.

Të njoftojë eprorin, për çdo problem që mund t'i lindë gjatë zbatimit të detyrës, dhe të ndjekë udhëzimet që i jepen nga eprori për vazhdimin e detyrës

Kandidatet duhet të plotesojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- ✓ Te jene shtetas shqiptare .
- ✓ Arsim I ulet ose I mesem.
- ✓ Te jene ne gjendje te mire shendetesore dhe te afte fizikisht.

DOKUMENTACIONI , MENYRA DHE AFATET E DOREZIMIT

1. CV
2. Fotokopje ID
3. Librezë Pune
4. Certifikatë personale
5. Certifikatë e gjendjes familjare
6. Diplome shkolle (e noterizuar)
7. Listë notash (e noterizuar)
8. Certifikatë/ Dokument për kualifikime të ndryshme/Specializime
9. Dëshmi Penaliteti
10. Vertetim i Gjendjes Gjyqësore
11. Vertetim prokurorie
12. Saktësim adrese nga Bashkia
13. Raport Mjekoligjor (Aftësi në punë)
14. Foto të vogla (2 copë), foto e madhe (1 copë)

Afati i aplikimit 5 dite.

Kandidatet do të vleresohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve , Drejtoria e Burimeve Njerezore do të shpallë fituesit në portalin “ Sherbimi Kombëtar I Punësimit”, në faqen e internetit.

Kandidatet jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Drejtorisë së Burimeve Njerezore . Afati I Ankimit është 3 (tre) ditë nga data e shpalljes së fituesit.

